



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Rrjeti i Grave të Kosovës: Për Zgjedhje të Barabarta dhe Dinjitet për Gratë në Politikë

Në prag të fushatës zgjedhore, u bëjmë thirrje të gjitha partive politike, kandidatëve/eve për deputetë/e dhe përfaqësuesve/eve publikë/e që të përmbahen nga përdorimi i gjuhës seksiste, mizogjene, denigruese apo diskriminuese ndaj grave dhe vajzave në politikë. Gjuha e urrejtjes, sulmet personale, komentet mbi pamjen, jetën private apo stereotipet gjinore nuk kanë vend në një proces demokratik që synon përfaqësim të barabartë dhe dinjitoz.

Zgjedhjet nuk duhet të jenë hapësirë ku gratë sulmohen, heshten apo përdoren vetëm për përmbushjen formale të kuotave. Përkundrazi, partitë politike duhet të jenë promovuese aktive të barazisë gjinore dhe të demokracisë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte të barabarta për pjesëmarrje dhe përfaqësim të grave në politikë.

U bëjmë thirrje partive politike që:

- të sigurojnë mbështetje të barabartë politike, financiare dhe mediale për të gjithë kandidatët dhe kandidatet;
- të mbështesin në mënyrë aktive gratë kandidate në lista, jo vetëm përmes nominimit formal, por edhe përmes promovimit të tyre të barabartë gjatë fushatës;
- të ndalojnë tolerimin e gjuhës seksiste dhe sulmeve gjinore nga anëtarët, militantët dhe mbështetësit e tyre;
- të promovojnë debat publik të bazuar në programe, politika dhe ide, e jo në misogjini dhe nënçmim të grave.

Demokracia nuk mund të jetë e plotë pa pjesëmarrjen e barabartë të grave. Përfaqësimi i grave nuk është privilegj, por e drejtë dhe domosdoshmëri për një shoqëri të drejtë dhe të barabartë. Çdo përpjekje për t'i diskredituar gratë përmes gjuhës seksiste apo dhunës verbale është sulm ndaj vetë demokracisë.

Kërkojmë nga mediat, institucionet përgjegjëse dhe shoqëria në tërësi që të mos normalizojnë seksizmin në diskursin publik dhe të kontribuojnë në krijimin e një klime zgjedhore të sigurt, të dinjitetshme dhe të barabartë për të gjitha gratë dhe vajzat që angazhohen në politikë.